



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr.346 AKTI

Nr.197 VENDIMI

VENDIM
NË EMER TË REPUBLIKËS

Gjykata e Apelit Administrativ, ne trup gjykues te perbere nga:

KASTRIOT SELITA -----Gjyqtar;
ENKELEJDA METALIAJ(SOFTA)-----Gjyqtare;
BERNINA KONDI-----Gjyqtare;

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Kristina PËRNASKA**, sot më dt.20.08.2019, pasi mori për shqyrtim seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.346 me palë:

PADITËS: **REXHEP BEKTESHI**, i biri i Hasanit dhe i Zeqije, i dtl 19.12.1957, lindur në Elbasan dhe banues në lagjen nr.6 Rr "Kasem Durrësi" pll 1999, përfaqësuar nga Avokat Vezir Barolli me prokurë të posaçme nr.1778 rep e nr 975/1 kol datë 14.08.2019.

IPADITUR: **KËSHILLI I EMERIMEVE NË DREJTËSISË**, me adresë Rr "Ibrahim Rrugova" ndërtesa nr.20, 1001 Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Laureta Nezaj, Këshilltare e Gjykatës së Lartë dhe pranë KED-së me autorizim e lëshuar nga Kryetari i KED-së me nr.494Prot datë 15.08.2019.

AVOKATURA E SHTETIT, TIRANË (në mungesë).

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimeve nr.91, nr.92 dhe nr.93 të datës 30.07.2019 të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi si të pabazuara në ligj e në prova dhe lejimin e gjyqtarit Rexhep Bekteshi për të kandiduar për vendin vakant për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018 dhe Presidenti i Republikës më datë 07.02.2018.

BAZA LIGJORE: Neni 44, 46, 48 e vijues të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative" 442, 452, 454, 466/b të K.Pr.Civile. Neni 43, 125 i Kushtetutës së RSH, nenet 3 pika 13 dhe 30 pika 2 gërma "a" i ligjit nr.45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", vendimi nr.4 datë 11.03.2019 "Për procedurë verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi.
Ligji nr.115/2016 “Për qeverisjen vendore”.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në mungesë të Avokaturës së Shtetit dhe në prani të palës paditëse dhe të palës së paditur dhe dëgjoji këta të fundit të cilët përfundimisht kërkuan :

Paditësi Rexhep Bekteshi, kërkoi: **Pranimin e ankimit. Shfuqimin e vendimit nr.91, 92, 93 të KED si të pabazuara në ligj dhe në prova.**

Palë e paditur Këshilli i Emërive në Drejtësisë, kërkoi: **Rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj.**

Avokatura e Shtetit, në mungesë.

Gjykata pasi mori për shqyrtim provat e paraqitura nga palët e i administroi ato në dosjen gjyqësore, shqyrtoi e bisedoi çështjen në tërësinë e saj.

VËREN

Kuvendi i Shqipërisë dhe Presidenti i RSh-së rezultojnë të ketë shpallur me datë dt.07.02.2018 dhe 12.02.2018, hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarëve Vladimir Kristo, Sokol Berberi dhe vakancën e parakohëshme të ish-gjyqtarit Besnik Ymeraj.

Në përfundim të kësaj procedure, Presidenti i Republikës rezultojnë t'i ketë përcjellë Këshillit të Emerimeve në Drejtësi, listën e plotë të kandidatëve që kishin shprehur interes për këtë vend vakant, përfshirë aplikimin e paditësit Rexhep Bekteshi.

Këshilli i Emerimeve në Drejtësi rezultojnë të ketë konfirmuar në mbledhjen e datës 05.04.2019, fillimin e procedurës së parashikuar në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, për verifikimin, vlerësimin, pikezimin dhe renditjen e këtyre kandidatëve, si edhe zgjedhjen e anetarit relator, për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikezimit dhe renditjes sekandaturave. Në funksion të zbatimit të kësaj procedure, Këshilli i Emerimeve në Drejtësi rezultojnë të ketë njoftuar me datë 05.04.2019, kandidatin Rexhep Bekteshi, për paraqitjen me qëllim pajisjen me formularin e deklaramentit dhe autorizimet respektive, brenda datës 10.04.2019. Kandidati Rexhep Bekteshi, me datë 09.04.2019 rezultojnë të jete pajisur nga Këshilli i Emerimeve në Drejtësi, me formularët e deklaramentit dhe autorizimet respektive, në funksion të vijimit të procedurës së verifikimit, duke nënshkruar edhe deklaratën që konfirmonte një fakt të tillë. Më dt.15.04.2019 kandidati Rexhep Bekteshi ka depozituar në sekretarinë e KED-së formularët e deklaramentit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, sipas vendimit nr.4, dt.11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”

Në lidhje me vlerësimin e figurës kandidati ka paraqitur vendimin nr.143, dt.26.04.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga përmbajtja e së cilit është bërë dhe vlerësimi i figurës. Me vendimin nr.4, dt.15.05.2019 Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka vendosur të korrigjojë gabimin material të vendimit, duke shtuar në pjesën arësytuese kapitulli III që trajton kontrollin e figurës. Vendimi korrigjuar është pjesë integrale e vendimit të arësytuar.

Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të ligjit nr.115/2016, të dispozitave të ligjit 45/2015, si dhe në zbatim të pikës 85 të vendimit të KED, nr.4/11/03/2019, me shkresën nr.112 Prot, dt.17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e

aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit për kandidatin Rexhep Bekteshi për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Kjo e fundit, me shkresën nr.550/8 prot, dt.10.05.2019, ka dërguar pranë KED vendimin nr.291, dt.09.05.2019, i cili përmban gjetjet dhe rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Rexhep Bekteshi.

KED, në dt.25.07.2019 ka njoftuar kandidatin Rexhep Bekteshi lidhur me shkresën nr.550/8 Prot, dt.10.05.2019, si dhe vendimin nr.291, dt.09.05.2019, duke i kërkuar kandidatit të japë shpjegimet e nevojshme deri më dt.26.07.2019, shpjegime që janë dërguar nga kandidati më dt.26.07.2019 po në mënyrë elektronike.

Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235,236 dhe 237 të ligjit nr.115/2016, si dhe pikave 29,75, 85 dhe 104 të vendimit nr.4, datë 11/03/2019, Këshilli i Emerimeve ne Drejtesi, ka proceduar me përgatitjen e relacioneve përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe çështja është çuar për shqyrtim në mbledhjen e këshillit. Ka rezultuar se Kryetari i KED-së në bazë të pikës 33 të vendimit nr.4, dt.11.03.2019 ka njoftuar anëtarët për mbledhjen e dt.30.07.2019, si dhe njoftimet bërë kandidatit Rexhep bekteshi duke i hërë me dije dhe relacionin përkatës.

Këshilli i Emerimeve ne Drejtesi rezulton te kete dipsonuar me vendimet nr.91, nr.92 dhe nr.93 të datës 30.07.2019 të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi për të njëjtën shkak nga ku është vendosur: *"1.Ndalimin e kandidimit te kandidatit Rexhep Bekteshi, per vendet vakante per gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi ne datën 12.02.2018 dhe Presidenti i Republikës me date 07.02.2018. 2. Ne zbatim te nenit 238 te ligjit nr.115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Rexhep Bekteshi. 3. Kandidati Rexhep Bekteshi ka te drejten e ankimit ne Gjykatën Administrative te Apelit, jo me vonë se 5 dite nga dita e njoftimit te vendimit te arsyetuar. 4. Ky vendim publikohet ne fletoren zyrtare te Gjykeses se Larte, ne pjesen e percaktuar per Keshillin e Emerimeve ne Drejtesi"*,vendime të cilat i janë njoftuar kandidatit më dt.08.08.2019 në rrugë elektronike.

Me date 13.08.2019, kandidati Rexhep Bekteshi rezulton te kete dorezuar ne rruge postare, kerkesë-padine e tij, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.91, nr.92 dhe nr.93 të datës 30.07.2019 të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi.

Pala paditëse pretendon se, keto vendime jane marrë në kushtet e nje dyshimi i cili nuk eshte verifikuar nga Keshilli i Emerimeve ne Drejtesi pasi vendimi nr.391, date 09.05.2019 i Autoritetit per Informimin mbi Dekumentat e Ish- Sigurimit te Shtetit nuk sqaron rrethanat e faktit per pozicionin tim ne hetimin e çështjes penale nr.148 të vitit 1990 ku pretendohet nga ky institucion se kam hetuar nje person per vepren penale te "Agjitacionit dhe Propogandes" parashikuar nga neni 55 i Kodit Penal ne fuqi ne kohen e ketij procedimi.

Keshilli i Emerimeve ne Drejtesi duhet te kishte kerkuar nga Autoriteti per Informimin mbi Dokumentat e Ish- Sigurimit te Shtetit nje kopje te akteve te dosjes per çështjen penale nr.148 te vitit 1990 mbi te cilen jane bazuar keto vendime.

Paditësi Rexhep Bekteshi nepermjet rruges elektronike ne datën 26.07.2019 ka paraqitur shpjegimet e tij prane Keshillit te Emerimeve ne Drejtesi duke parashtruar se: *"Siç kam deklaruar ne dokumentat e paraqitura ne aplikimin tim, per periudhen e viteve 1980-1991, kam punuar hetues ne Hetuesine e Rrethit Durrës. Kam hetuar çështje per veprat penale ne Sektorin e Hetimit te "Veprave penale Kunder Jetës dhe Shendetit te Personit e Vjedhjes se Pasurise" (sipas emertimit te kohes). Nuk kam qene hetues per vepra penale kunder shtetit dhe nuk kam marre pjese ne hetime te proceseve politike te posaçme. Referuar çështjes penale qe permendet nga Autoriteti per Informimin e mbi Dekumentat e ish-Sigurimit te Shtetit nuk mbaj mend konkretisht kete rast, por mendoj se ky rast ka qene per çështje penale te "Vjedhjes se Pasurise" (qe hetohej nga sektori*

ku une punoja) e ndërthurur me "Agjitacion e Propogande". Kjo per faktin sepse sektori i hetimit per "Vepra penale Kunder Jetes dhe Shendetit te Personit e Vjedhjes se Pasurise" nuk bente hetime per çeshtjet e krimeve kunder shtetit".

Keshilli i Emerimeve ne Drejtësi ne dhenien e ketyre vendimeve nuk e ka hetuar kete rast te pretenduar nga Autoriteti per Informimin mbi Dekumentat e Ish- Sigurimit te Shtetit me vendimin nr.391 date 09.05.2019 por eshte mjaftuar vetem me konkluzionin e ketij Institucioni.

Ne këto kushte duke qënë se nga Autoriteti për Informimin mbi Dekumentat e Ish- Sigurimit te Shtetit pretendohet vetem per një rast te vetem dhe hetimet per krime kunder shtetit te proceseve politike te posaçme nuk ka qene objekt i punës time per periudhen e viteve 1980-1991, mendoj se Keshilli i Emerimeve ne Drejtësi duhej te kishte treguar kujdesin e duhur per të hetuar kete rast qe me ka demtuar padrejtësisht imazhin tim. Në seancë gjyqësore pala paditëse paraqiti me cilësinë e provës dosje hetimore nr.148/1990 vendim gjyqësor nr.88, dt.10.05.1990 të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe vendimin nr.55, dt.30.05.1990 nga Gjykata e lartë, Kolegji Penal nga ku është vendosur " *Ndryshimin e vendimit nr.88, dt.10.05.1990 të Gjykatës së Rrethit Durrës si vijon "Të deklarojë fajtor të pndehurin Rifat Mysliu për krimin e fyerjes së përfaqësuesit të organeve më të larta të shtetit e të partisë, dhe në bazë të nenit 118 të K.Penal (të ndryshuar) ta dënojë me 1 vit heqje lirie".*

KED ka gabuar në zbatimin e ligjit për pengesat që ka subjekti për të kandiduar në vënd vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese pasi hetimi i çështjes penale nr.148/1990 të cilën mund ta ketë kryer z.Rexhep Bekteshi nuk përfshihet në legjislacionin që e pengon atë për të kandiduar në vëndet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Në kërkesë-padinë e paraqitur dhe gjatë gjykimit të çështjes, pala paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka parashtruar këto pretendime:

- Në asnjë moment qoftë relatori i çështjes apo anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, çdo veprim që kanë kryer kanë qënë në përputhje të plotë me qëllimin që u ka vendosur ligji si dhe duhet theksuar se ka qënë një nga organet kushtetuese më transparente dhe më bashkëpunëtore.
- Kjo mosmarrveshje dhe ky gjykim ka për objekt vetëm çështje të së drejtës procedurale të respektuar ose jo nga ana e Këshillit të Emerimeve në Drejtësi.
- Duke iu referuar nenit 238 të ligjit nr.115/2016 ndaj vendimeve të KED-së mund të bëhet padë vetëm për shkelje të rënda procedurale.
- Që të pretendohet se kemi shkelje të rënda procedurale pra i gjithë procesi është nul duhet të plotësohet të paktën njëri nga elementët e parashikuar nga neni 108 të K.Pr.Administrative përndryshe nuk mund të pretendohet se jemi përpara nulitetit për shkak të interpretimeve të ndryshme të ligjit.
- Në rastin objekt gjykimi nga ana e KED-së procedura është respektuar në mënyrë rigorozë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë". Nga ana e KED janë respektuar në mënyrë rigorozë kërkesat e neneve 98, 99 dhe 100 të K.Pr.Administrative.
- Pretendimi i ankuesit se "Këshilli i Emerimeve në Drejtësi në dhënien e këtyre vendimeve nuk e ka hetuar këtë rast të pretenduar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit me vendimin nr.391 datë 09.05.2019 por është mjaftuar vetëm me konkluzionin e këtij Institucioni" ky pretendim është i pabazuar, vetë ankuesi i është

njoftuar gjetja dhe pas këtij njoftimi ankuesi (kandidati) Rexhep Bektashi në e-mailin e datës 26.07.2019 drejtuar Këshillit ka dhënë shpjegimet përkatëse në lidhje me gjetjet e sipërcituara.

- Po të referohemi vendimeve objekt gjykimi nga pika 30 e tij deri në pikën 35 është arsyetuar dhe sqaruar në mënyrë shteruese vendimmarrja e këshillit për ndalimin e kandidimit të ankuesit si dhe iu ka dhënë përgjigje edhe pretendimeve që janë ngritur në këtë ankim nga ankuesi duke arsyetuar faktet, rrethanat dhe provat.
- Nuk mund të pretendohet se kemi shkelje të rënda proceduriale për mosarsyetim, vetëm se arsyetimi ezaures i KED-së në vendimet objekt gjykimi është i kundërt me interesat apo pritshmëritë e ankuesit.

Vlerësimi i Kolegjit të Gjykatës Administrative të Apelit:

I. Lidhur me kushtet e pranueshmërisë së padisë:

Gjykata Administrative e Apelit, kryesisht konstatoi se kjo çështje hyn në kompetencën e saj funksionale, në kuptim të nenit 10/2.b të ligjit nr. 49/2012, që parashikon se:

"2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

...

b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj."

Konkretisht, neni 238/1 i Ligjit Nr.115/2016 "Per organet e qeverisjes te sistemit te drejtesise",parashikon se: *"1.Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar"*.

Gjykata e Administrative Apelit konstatoi gjithashtu kryesisht se, çështja me keto dy kërkitime, perben lende juridiksioni gjyqësor dhe se ajo hyn ne kompetencen lendore tesaj, bazuar ne nenin 7 te ligjit nr.49/2012, sipas përmbajtjes së të cilit: *"Gjykatat administrative jane kompetente per: a)mosmarreveshjet qe lindin nga aktet administrativeindividuale, aktet nenligjore normative dhe kontratatadministrative publike, te nxjerra gjate ushtrimit te veprimtarise administrative nga organi publik..."*.

Vendimet objekt shqyrtimi gjyqësor janë akte administrativ individuale ne kuptim te nenit 2/1, 2 të ligjit nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative". i ndryshuar, sipas përmbajtjes se te cilit: *1."Akt administrativ" është çdo akt administrativ individual dhe çdo akt nënligjor normativ. 2."Akt administrativ individual" është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete".* Vendimet objekt shqyrtimi gjyqësor perbejnë vullnet te shprehur te Keshillit te Emerimeve ne Drejtesi, per ndalimin e kandidimit te paditesit Rexhep Bektashi , ne vendin vakant per gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese,

II. Sa i takon legjitimitit te paditesit, gjykata vëren paraprakisht se, për të parashtruar një kërkitim në gjykim ose për të kundërshtuar këtë kërkitim, është e nevojshme që pala që investon gjykatën, të ketë interes. Ky interes është dobia personale për të kërkuar me anë të gjykatës, njohjen ose

rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, që përbën një nga kushtet formale të padisë në gjykimin administrativ, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Interesi duhet të jetë aktual, domethënë se dëmi që i shkaktohet paditësit dhe që kërkohet të shmanget me padinë, duhet të ketë ngjarë në kohën e ngritjes së padisë ose të vërtetohet në një kohë të ardhme shumë të afërt, jo thjeshtë të ardhme.

Sipas nenit 15, të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar:

"Të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

b) organi i administratës publike, që pretendon se është cenuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor normativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike. Në këtë rast, organi shtetëror mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit;

Paditësi Rexhep Bekteshi është një ndër personat që kanë shprehur interes për të kandiduar për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, procedura e kandidimit të të cilit rezultoi të jete ndërprerë me aktet objekt gjykimi, për të njëjtin shkak.

III. Në lidhje me afatin e kundërshtimit të vendimeve objekt shqyrtimi gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësi është brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 238/1 i ligjit 115/2016. *"I. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimitve të për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar".*

Në rastin konkret, vendimi nr.91,92,93, Dt.30.07.2019 i Këshillit të Emerimeve në Drejtësi rezultoi të jete komunikuar kandidatit Rexhep Bekteshi, në rrugë elektronike, me date 08.08.2019, ndërsa padia rezultoi të jete dorëzuar dorazi nga vetë kandidati me date 13.05.2019, pranë sekretarisë së kësaj gjykate, pra brenda afatit ligjor 5-ditor.

IV. Gjykata Administrative e Apelit nuk identifikoi asnjë dispozite ligjore që e kushtëzon ngritjen e padisë në këtë rast, me shterimin e ankimit administrativ.

Mbi themelin e pretendimeve. Gjykata Administrativ e Apelit në funksion të analizës e pretendimeve të ngritura në padi dhe të prapsimeve, dikton zbatimin e kufijve të shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 37/1 të ligjit nr.49/2012, sipas përmbajtjes së të cilit: *"I. Gjykata shqyrton ligjshmerinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatesligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ".*

Ligji i zbatueshëm është ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", parashikon nepermjet dispozitave të tij, procedurën që duhet zbatuar, për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe konkretisht:

Neni 234/1 *"I. Presidenti i Republikës i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Presidenti i Republikës, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Presidentit".*

Neni 235 "Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë së kandidatëve" 1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjessë interesit nga kandidatët, Këshilli i Emerimeve në Drejtësi i pajiskandidatët me formularët për deklarinimin e pasurive dhe të interesave financiarë. 2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarinimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuar pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarinimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij. 3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatat e kontrollit. 4. Me përfundimin e procedurës së deklarinimit dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar, si dhe vendimi nr.4, dt.11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë"

K.Pr.Administrative, neni 108, parashikohen rastet e pavlefshmerisë absolute të aktit administrativ, sipas përmbajtjes së të cilit: "Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij: ...".

Neni 109 parashikon se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës; b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative".

Lidhur me themelin e çështjes. Nepermjet akteve shkresore të administruara gjatë gjykimit Këshilli i Emerimeve në Drejtësi rezultoi të ketë disponuar me vendimet nr.91, nr.92 dhe nr.93 të datës 30.07.2019 të Këshillit të Emerimeve në Drejtësi për të njëjtën shkak nga ku është vendosur: "1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Rexhep Bekteshi, për vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018 dhe Presidenti i Republikës me datë 07.02.2018. 2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr.115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Rexhep Bekteshi. 3. Kandidati Rexhep Bekteshi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. 4. Ky vendim publikohet në fletoren zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e percaktuar për Këshillin e Emerimeve në Drejtësi".

Të treja aktet administrative kanë një shkak që kanë ndaluar kandidimin e paditësit Rexhep Bekteshi, konkretisht me arsyetimin „pika 35” – KED vlerëson se të dhënat që janë paraqitur nga AIDSSH lidhur me kandidatin Rexhep Bekteshi, përbëjnë motiv për të vlerësuar mospërmbushjen nga ky kandidat të kushtit ligjor të lidhur me integritetin e kandidatit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, bazuar me këto gjetje për verifikimin e figurës së kandidatit, në zbatim të pikës 5 të nenit 125 dhe 147/d të Kushtetutës, të nenit 229 e 236 të ligjit 115/2016, nenit 29 të ligjit 45/2015 dhe pikës 88 të vendimit nr.4, dt.11.03.2019, Këshilli procedon me ndalimin e kandidimit të kandidatit Rexhep Bekteshi për vendet vacant të shpallur nga Kuvendi më dt.12.02.2018 dhe Presidenti i Republikës më dt.07.02.2018".

Pala paditëse pretendon pavlefshmëri absolute të akteve administrative objekt shqyrtimi gjyqësor për shkak se nuk ka hetuar në lidhje me informacionin e ardhur nga AIDSSH me vendimin nr.391 datë 09.05.2019. Kolegji, vlerëson se pretendimet e kandidatit janë të pambështura në ligj.

Neni 238/1 i ligjit 115/2016 që e bën kompetente këtë gjykatë nga pikëpamja e lëndës ndër të tjera ka parashikuar se: 1.*Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit*.

Që të pretendohet shkelje të rënda procedurale, pra që i gjithë procesi që ka zhvilluar KED në bazë të ligjit nr.115/2016 dhe vendimi nr.4, dt.11.03.2019 "Për për zgjedhjen e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese" të jetë "NUL". Që ky proces të jetë nul duhet që të jemi përpara të paktën e njëjës prej shkeljeve të dispozitës nenit 108 të K.Pr.Administrative, ku parashikohet se:"Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik.

ii) procedurën e nxjerrjes së tij

iii) formën ose elementët të tjerë të detyrueshëm të aktit,

a) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit , kanosjes,mirmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale,

b) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm , sipas legjislacionit penal';

ç) në çdo rast tjetër të parashikuar me ligj.

Gjithashtu, në nenin 109 të K.Pr.Administrative, parashikohet se:

"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

a) **organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës."**

b) Është rezultat i shkeljes së dispozitave që rregullojnë formën apo elementët e detyrueshme të aktit administrativ

c) Është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formë apo elementët e detyrueshme të aktit administrativ,

ç) Është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4 të këtij Kodi.

d) është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material

dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme apo

d) Nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Ka rezultuar gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje se nga ana e palës së paditur janë zhvilluar të gjitha procedurat në bazë të ligjit nr.115/2015 "Per organet e qeverisjes së sistemit në drejtësi", dhe vendimi nr.4, dt.11.03.2019 të KED dalë në zbatim të këtij ligji i cili parashikon të gjithë procedurën që do ndiqet për të gjithë kandidatët për në Gjykatën Kushtetuese.

Nepermjet akteve shkresore te administruara gjate gjykimit, rezulton te jete konfirmuar se:

- Kuvendi i Shqiperise dhe Presidenti i Republikës rezulton te kete shpallur me date 12.02.2018, dhe dt.07.02.2018 hapjen e procedures se aplikimeve per plotesimin e vendit

vakant të krijuar pas ndërprerjes para afatit, të mandatit të njerit prej tre anetareve të Gjykatës Kushtetuese. Në përfundim të kësaj procedure, Presidenti i Republikës rezultoi t'i ketë përcjellë Këshillit të Emerimeve në Drejtësi, listën e plotë të kandidatëve që kishin shprehur interes për këtë vend vakant, përfshirë aplikimin e paditesit Rexhep Bekteshi.

- Këshilli i Emerimeve në Drejtësi rezultoi të ketë konfirmuar në mbledhjen e datës 05.04.2019, fillimin e procedurës separashikuar në ligjin nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" për verifikimin, vlerësimin, pikezimin dhe renditjen e këtyre kandidatëve, si edhe zgjedhjen e anetarit relator, për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikezimit dhe renditjes së kandidaturave.
- Në funksion të zbatimit të kësaj procedure, Këshilli i Emerimeve në Drejtësi rezultoi të ketë njoftuar me datë 05.04.2019, kandidatin Rexhep Bekteshi, për paraqitjen me qëllim pajisjen me formularin e deklaramentit dhe autorizimet respektive, brenda datës 10.04.2019.
- Kandidati Rexhep Bekteshi, me datë 09.04.2019 rezultoi të jetë pajisur nga Këshilli i Emerimeve në Drejtësi, me formularin e deklaramentit dhe autorizimet respektive, në funksion të vijimit të procedurës së verifikimit, duke nënshkruar edhe deklaratën që konfirmonte një të tillë fakt.
- Më dt.15.04.2019 kandidati Rexhep Bekteshi ka depozituar në sekretarinë e KED-së formularin e deklaramentit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, sipas vendimit nr.4, dt.11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë".
- Në lidhje me vlerësimin e figurës kandidati ka paraqitur vendimin nr.143, dt.26.04.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga përmbajtja e së cilit është bërë dhe vlerësimi i figurës. Me vendimin nr.4, dt.15.05.2019 Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka vendosur të korrigjojë gabimin material të vendimit, duke shtuar në pjesën arësytuese kapitulli III që trajton kontrollin e figurës. Vendimi korrigjuës është pjesë integrale e vendimit të arsyetuar.
- Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të ligjit nr.115/2016, të dispozitave të ligjit nr.45/2015, si dhe në zbatim të pikës 85 të vendimit të KED, nr.4/11/03/2019, me shkresën nr.112 prot, dt.17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit për kandidatin Rexhep Bekteshi për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Kjo e fundit, me shkresën nr.550/8 prot, dt.10.05.2019, ka dërguar pranë KED vendimin nr.291, dt.09.05.2019, i cili përmban gjetjet dhe rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Rexhep Bekteshi.
- KED, në dt.25.07.2019 ka njoftuar kandidatin Rexhep Bekteshi lidhur me shkresën nr.550/8 prot, dt.10.05.2019, si dhe vendimin nr.291, dt.09.05.2019, duke i kërkuar kandidati të japë shpjegimet e nevojshme deri më dt.26.07.2019, shpjegime që janë dërguar nga kandidati më dt.26.07.2019 po në mënyrë elektronike.

Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr.115/2016, si dhe pikave 29,75, 85 dhe 104 të vendimit nr.4, dt. 11/03/2019, Këshilli i Emerimeve në Drejtësi, ka proceduar me përgatitjen e relacioneve përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe çështja është çuar për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit. Ka rezultuar se Kryetari i KED-së në bazë të pikës 33 të vendimit nr.4, dt.11.03.2019 ka njoftuar

anëtarët për mbledhjen e dt.30.07.2019, si dhe njoftimet bërë kandidatit Rexhep Bekteshi duke i bërë me dije dhe relacionin përkatës.

Konkretisht, në gjykim nga pala paditëse nuk është pretenduar shkelja e procedurës për mungesën e kompetencës, procedurën e nxjerrjes së aktit, formën ose elementët e tjetër të detyrueshem të aktit apo dhe pika të tjera të dispozitës së lartpërmendur por thekson **se nuk ka hetuar në lidhje me çështjen në fjalë. Në lidhje me këtë fakt, Kolegji vlerëson se KED mbi bazën e informacionit të ardhur nga AIDSSH me vendimin nr.391 datë 09.05.2019, ka njoftuar kandidatin në rrugë elektronike për të dhënë shpjegime, shpjegimet të cilat janë nisur nga kandidati më dt.16.07.2019 po në rrugë postare, çka do të thotë se nuk jemi përpara faktit të mos hetimit të faktit. Në seancë gjyqësore paditësi Rexhep Bekteshi pretendoi se nuk i është dhënë mundësia të paraqesë provat që i paraqiti në seancë gjyqësore (bëhet fjalë për: dosje hetimore nr.148/1990 vendim gjyqësor nr.88, dt.10.05.1990 të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe vendimin nr.55, dt.30.05.1990 nga Gjykata e Lartë, Kolegji Penal nga ku është vendosur "Ndryshimin e vendimit nr.88, dt.10.05.1990 të Gjykatës së Rrethit Durrës si vijon "Të deklarojë fajtor të pandehurin Rifat Mysliu për krimin e fyerjes së përfaqësuesit të organeve më të larta të shtetit e të partisë, dhe në bazë të nenit 118 të K.Penal (të ndryshuar) ta dënojë me 1 vit heqje lirie").**

Kolegji dhe këto pretendime i konsideron të pambështetura pasi, sipas vendimit nr.4, dt.11.03.2019 të KED, kandidati nëse nuk ka mundësi të japë informacion në lidhje me sa i kërkohet ai mund të shtyjë këtë afat për një kohë të mëpasshme 3-5 ditore me qëllim vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret.

Gjithashtu, Kolegji vlerëson se pretendimet e paditësit hyjnë në lidhje me themelin (shkakun e daljes së aktit administrativ në themel të saj, pra me mospërbushjen e njëres prej kritereve që të mund të lejojnë kandidimin për në Gjykatën Kushtetuese) dhe jo, për procedurën e shkelur sikundër parashikon dispozita neni 238/1 i ligjit nr.115/2019.

Në lidhje me kërkimin e dytë "lejimin e kandidimit nga gjykata", Kolegji vlerëson se në kuadër dhe të arsyetimit të lartpërmendur është një kërkim i pambështetur në ligj, pasi sikundër u citua sa sipër, Kjo Gjykatë shqyrton vetëm shkeljet e rënda të procedurës dhe, nuk ka tagra të lejojë apo moslejojë kandidimin e kandidatit, pasi mbi bazën e ligjit nr.115/2016 kjo tagër i është dhënë vetëm KED-së.

Përfundimisht, Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson se, shkakun i vetem qe per ligj venien ne diskutim gjyqesisht, te vendimit te Keshilli te Emerimeve ne Drejtesi, per ndalimin e kandidimit per plotesimin e nje vendi vakant ne Gjykatën Kushtetuese, ka te beje me shkeljet e rënda procedurale ne nxjerrjen e ketij akti. Ligji nr.115/2016 "Per organet e qeverisjes te sistemit te drejtesise", dhe vendimi nr.4, dt.11.03.2019 dalë në zbatim të këtij ligji i cili parashikon të gjithë procedurën që do ndiqet për të gjithë kandidatët për në Gjykatën Kushtetuese per plotesimin e vendit vakant per gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese. Referuar situates faktike lidhur me kete konflikt, rezulton qe Keshilli i Emerimeve ne Drejtesi te mos kete reflektuar asnje shkelje procedurale, aq me pak te rende, gjate procesit te verifikimit te deklarimeve te kandidati Rexhep Bekteshi, çka do të thotë se aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor nr.91, 92, 93, dt.30.07.2019 të KED janë akte të dala konform ligjit dhe duhet të mbeten në fuqi.

Shpenzimet gjyqësore lidhur me këtë çështje, përbëhen nga taksa mbi aktet në vlerën 3,000 lekë, parapaguar nga paditësi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 40, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, neni 238/1 i ligjit nr.115/2016"Per organet e qeverisjes te sistemit te drejtesise"

VENDOSI

- Rrëzimin e padisë .
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
- Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.
- U shpall sot 20/08/2019 në Tiranë.

GJYQTARE
BERNINA KONDI

d.v

GJYQTARE
ENKELEJDA METALIAJ(SOFTA)

d.v

GJYQTAR
KASTRIOT SELITA

d.v

Vërtetohet njësia me origjinalin

Leonard STRATAJ